

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA FINIQ

Data

15.02.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje karburant Gaz,Benzin,Diesel per vitin 2024

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):09100000-0
karburante

VLERA E FONDIT LIMIT:

18.333.333 (tetembedhjetemilione e treqinde tridhjetë tre mijë e treqinde tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

I mbajtur sot me date 12.02.2024 ne Autoritetin Kontraktor Bashkia Finiq, ne mbledhjen e njesise se prokurimit te perbere prej Florida Lula,Eduart Merkuri,Vangjel Kaçi ngritur sipas Urdhërit te Prokurimit Nr.1, datë 02.02.2024 per argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve te veçanta te pranimit te procedures se prokurimit me objekt: “Blerje karburant Gaz,Benzin,Diesel per vitin 2024”,prokurim elektronik “Procedure e hapur”, me fond limit 18.333.333 (tetembedhjetemilione e treqinde tridhjetë tre mijë e treqinde tridhjetë e tre) leke pa përfshirë vleftën e TVSH-së, sipas perlllogaritjeve te kryera.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Finiq ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

(Shënim: *përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit financiare/ushtrimore/buxhetore (2020-2021-2022) nga data e zhvillimit të procedurës së tenderit, **ku të arihet vlera e xhiros minimale, e cila në rastin konkret është vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit.

2.2.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: 2020, 2021-2022 të certifikuara pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të shoqeruara nga akt ekspertiza e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar në përputhje me ligjin nr.10091 datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar”, neni 41,pika c. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, janë vendosur kriteret e mësipërme, për të vërtetuar se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën me sukses.

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vertetim të lëshuar nga autoritetet vendore, për shlyerjen e taksave vendore për të gjitha vendet ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin sipas QKB –së ,ne zbatim të ligjit nr.9632, date 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vertetimin e lëshuar nga Bashkia.

Për plotesimin e kriterit të mesiperm të pikës është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 (Formulari përmbledhës i vetedeklarimit).

Ne lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit deshmues për kërkesat që përshihen në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, mbajme në konsideratë përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertes, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

Dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme me vlerë totale 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe **që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Si dëshmi për përvojën e mëparshme, OE duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara (sipas shtojcës nr.9).

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Flete analiza të leshuar nga ISHTI

Per plotesimin e kriterit të mesiperm të pikes është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 (Formulari përmbledhës i vetedeklarimit).

Ne lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit deshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, mbajme në konsideratë përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikes 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese të ofertes, të dorezuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 37 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44 pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.3. Operatori duhet të ketë të paktën 1 (një) pikë shpërndarje të karburantit brenda territorit të Bashkisë FINIQ, pasqyruar tek të dhënat në QKB, vetëtuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate noteriale ose akt pronësie) për këtë stacion.

Per plotesimin e kriterit të mesiperm të pikes është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 (Formulari përmbledhës i vetedeklarimit).

Ne lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit deshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, mbajme në konsideratë përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikes 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese të ofertes, të dorezuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër të furnizojë në stacionin të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë në çdo ditë të javës, me karte elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të autoritetit kontraktor, ose tollona, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor. Subjekti merr përsipër që të konvertojë të gjithë sasitë e litrave të ndodhura në kartën elektronike të personalizuar me targën e mjetit, deri në perfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor. Karta elektronike duhet të jetë pa skadencë dhe të jetë e përdorshme dhe gjatë vitit 2024.

Për plotësimin e kriterit të mësipërm të pikës është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 (Formulari përmbledhës i vetedeklarimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të tarqesë License të vlefshme për tregtimin e karburanteve e leshuar nga Ministria përkatëse ose autorizim të vlefshëm për tregtimin e karburanteve të leshuar nga Njësiti e Qeverisjes Vendore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente .

2.3.6. Në zbatim të VKM-së nr.710, datë 24.11.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 5, operatori ekonomik duhet të paraqesë së bashku me Formularin e ofertes, analizat e kostove për Gazoil 10 ppm, Benzinë (Premium Unl 10PPm) dhe Gas të paraqitura në ofertën ekonomike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë

*cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

EN 590:2013+A1:2017

Tabela 1-kërkesat e përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provës për karburant gazoil (10 ppm ULSD)

Substanca	Njësia matëse	Limitet (normat)		Metoda e provës (shih klauzolës 2)
		Minimum	Maksimumi	
Numri i Cetanit		51	-	EN ISO 5165 EN 15195 EN 16144
Indeksi Cetanit		46,0	-	EN ISO 4264
Densiteti në 15 gradë celcius	Kg/m ³	820,0	845,0	EN ISO 3675 EN ISO 12185
Hidrokarbure Polycyclic aromatike	% (m/m)	-	8,0	EN 12916
Përmbajtje squfuri	mg/kg	-	10,0	EN ISO 20846 EN ISO 20884 EN ISO 13032
Përmbajtje Mangani	mg/l			

Deri 31-12-2013				Pr EN 16576
Nga 01.01.2014 në vazhdim		-	6,0	
		-	2,0	
Pika e ndezjes	Gradë celsius	Mbi 55	-	EN ISO 2719
Karboni i mbetur (në 10%mbetje distilati)	% (m/m)	-	0,30	EN ISO 10370
Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,010	EN ISO 6245
Përmbajtja e ujit	mg/kg	-	200	EN ISO 12937
Kontaminimi total	mg/kg	-	24	EN 12662
Gërryerja e shiritit bakrit (3 orë në 50 gradë celsius)	Grada	Grupi 1		EN ISO 2160
Përmbajtja e Acidit të ngopur metil ester FAME	% (V/V)	-	7,0	EN 14078
Qëndrueshmëria e oksidimit	g/m ³	-	25	EN ISO 12205
	h	20	-	EN 15751
Lubrifikimi, diametri i veshjes së mprehte (wsd 1,4) në 60 gradë Celsius	µm (micrometer)	-	460	EN ISO 12156-1
Viskoziteti në 40 gradë Celsius	Mm ² /s	2,000	4,500	EN ISO 3104
Distilimi				EN ISO 3405
% (V/V) rafinimi në 250 gradë celsius	% (V/V)		Më pak se 65	EN ISO 3924
% (V/V) rafinimi në 300 gradë Celsius	% (V/V)	85	360	

95 % (V/V)rafinimi në	Gradë celsius			
Shënim: Kërkesat me Bold i referohen Direktivës Evropiane të Karburanteve 98/70 /EC (1), duke përfshirë amendamentet 2003/17/EC (2), 2009/30/EC (3) dhe 2011/63/EU (4).				
<ul style="list-style-type: none"> a. Shih gjithashtu 5.7.1. b. Shih gjithashtu 5.7.4. c. Shih gjithashtu 5.7.2. d. Për qëllimet e këtij Standardi Evropian, hidrokarbonet policiklikë aromatikë janë caktuar si përmbajtja totale e hidrokarboneve aromatike më pak se përmbajtja e hidrokarboneve mono-aromatike, të dyja të përcaktuara në EN 12916. e. Shih gjithashtu 5.7.3. f. Shih gjithashtu 5.2.2. g. Shih gjithashtu 5.2.2. dhe Aneksi A. h. Investigimi i mëtejshëm për kontaminimin total në metodën e provës për përmirësimin e saktësisë, veçanërisht për prezencën e FAME, nën mbikëqyrjen e CEN. i. FAME i përkojnë kërkesat e EN 14214, shih (3). j. Kur karburantet e naftës përmbajnë më shumë se 2 % (V/V) FAME , qëndrueshmëria e oksidimit e përcaktuar në EN 15751 është kërkesa për të. k. Për llogaritjen e indeksit të Cetanit 10%, 50 % dhe 90% (V/V)nevojiten gjithashtu pikat e RECOVERY. l. Limitet e distilimit në 250 gradë Celsius dhe 350 gradë Celsius janë përfshirë në tarifën e karburantit naftë të Doganave të përbashkëta të BE. m. EN ISO 3924 jep instruksione për konvertimin në ISO 3405-të dhëna ekuivalente. Shih gjithashtu 5.7.5. 				

EN 228:2012 + A1 :2017 (E)

15367, Pjesët 2 dhe 3 respektivisht (7,8). Një metodë përcaktimi për komponentët me zierje të lartë në benzinën pa plumb është nën zhvillim e sipër nga CEN.

Në vijim, Tabela 2- Kërkesa dhe metoda testi për benzinën pa plumb me përmbajtje oksigjeni maksimum prej 2.7% (m/m)

Vetitë	Njësitë	Kufizimet		Metoda Testi ^a (Shih Referenca normative) 2.
		Min	Max	
Numër Oktani Kërkimi, RON		95,0		EN ISO 5164 b
Numër Oktani Makine, MON		85,0		EN ISO 5163 b
Përmbajtje plumbi	Mg/l		5,0	EN 237
Densiteti (në 15°C) c	Kg/m ³	720,0	775,0	EN ISO 3675 EN ISO 12185
Përmbajtje Sulfuri c	Mg/kg		10,0	EN ISO 13032 EN ISO 20846 EN ISO 20884
Përmbajtje manganezi d Deri 31-12-2013 Nga 01-01-2014	Mg/l		6,0 2,0	EN 16135 EN 16136
Qëndrueshmëria oksidimit e	Min.	360		EN ISO 7536
Përmbajtja e gomës ekzistente (solvent i larë)	Mg/100ml		5	EN ISO 6246
Rrip korrozioni bakri 3 h në 50 °C	Vlerësim	Klasi 1		EN ISO 2160
Dukshmëria e		I qartë dhe i ndritshëm		Inspektim vizual
- Përmbajtja e tipit të hidrokarbonit c - Olefinë - Aromatik	% (V/V)		18,0	EN 15553 EN ISO 228 54

			35,0	
Përmbajtja e benzolit c	% (V/V)		1,00	EN 238 EN 12177 EN ISO 22854
Përmbajtja e oksigjenit c	% (m/m)		2,7	EN 1601 EN 13132 EN ISO 22854
Përmbajtja e oksigjenatit c	% (V/V)		3,0 5,0	EN 1601 EN 13132 EN ISO 22854
- Methanol - Etanol g - Alkool Iso-propil h - Alkol Iso-butyl h - Alkool Tert-butyl h - Eterë (5 ose më shumë atome C) h - Oksigjenate të tjera hi			Përzierje volumi e kufizuar në 2.7% (m/m) përmbajtja max. e oksigjenit	
SHËNIM: Kërkesat e theksuara me bold i referohen Direktivës Evropiane të Karburanteve 98/70/EC (1) duke përfshirë amendamentet në vijim (2), (3) dhe (4)				
(a) Shih gjithashtu 5.7.1				
(b) një korrektrim i 0,2 për MON dhe RON do të zbritet për përlogaritjen e rezultatit final përpara raportimit sipas kërkesës së Direktivës Evropiane të Karburanteve 98/70/EC (1) duke përfshirë amendamentet në vijim (2), (3) dhe (4). Shih gjithashtu 5.6 dhe 5.7.2				
(c) Shih gjithashtu 5.7.2				

(d) Shih gjithashtu 5.3.3

(e) Dukshmëria do të përcaktohet në temperaturë ambienti

(f) Do të shtohen agjentë stabilizues

(g) Kur përdoret etanoli si komponent përzierjeje do të bëhet në përshtatje me EN 15376 (Shih 5.1). Agjentë stabilizues mund të shtohen.

(h) Përmbajtja e oksigjenit të benzinës së pastër pa plumb nuk do të kapërcej 2,7% (m/m). Një CEN/TR mbi përzierjen oksigjenate është në përgatitje e sipër.

(i) të tjera monoalkoolike dhe eterë me një pikë zierjeje të fundit jo më të lartë se sa përshkruhet në Tabelën 4

GAZI LENGSHËM

Gazi i lëngshëm duhet të ketë karakteristikat e GLN, në përputhje me Standardin Shqiptar S SH EN 589:2006.

Gazi i lëngshëm është përzierje e hidrokarbureve të gazeve propan 65 % dhe butan 35 %, **me erën karakteristike të tij dhe gjatë djegies krijon një flakë me ngjyrë qielli në blu.**

Sa me sipër Njesia e Prokurimit

vendosi:

1. Miratimin e specifikimeve teknike të objektit “Blerje karburant Gaz,Benzin,Diesel për vitin 2024”.
2. Miratimin e krieteve të veçanta të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje karburant Gaz,Benzin,Diesel për vitin 2024”.
3. Në zbatim të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021, neni 45, pika 2, Kriter vlerësues të jete:
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim
4. Procedura për hapjen e ofertave do të zhvillohet në datën 15.03.2024, Ora 10⁰⁰

Në zbatim të Udhezimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr.7, datë 30.07.2021”Për mënyrën e zhvillimit të prokurimeve me mjete elektronike”, pika 3, Manuali teknik, Njesia e Prokurimit autorizon znj.Florida LULA për të kryer veprimet në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE).

PER NJESINE E PROKURIMIT

Florida LULA

Eduart MERKURI

Vangjel KAÇI